



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË

Nr. 3067 prot.

Vlorë, më 13 . 03 2023

PROJEKT VENDIM

Nr \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ 2023

**“PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË TË ARDHURAVE PËR  
PROGRAM BUXHETIN AFATMESËM 2024-2026”**

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni pika 2, neni 9 pika 1.1b të Kreut III, neni 34 pika 6, neni 41 pika 1, neni 64 pika c të Kreut X, i ndryshuar: Ligjin Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 33, 34, 35, 36, 37. Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet e bëra. Udhëzimi plotësues Nr.2 datë 19.01.2023 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2023”, Udhëzimin Nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit” si dhe Udhëzimi plotësues Nr.6 datë 28.02.2023 “Për Përgatitjen e Programit Afatmesëm Vendor 2024-2026”

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë planin e të ardhurave për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026:

	2024	2025	2026
Plani i transfertës së pakushtëzuar	710,738	748,811	788,025
Plani i transfertës specifike	451,928	456,447	461,011
Plani i te ardhurave të Bashkisë Vlorë	1,498,846	1,554,460	1,609,307
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>2,661,512</b>	<b>2,759,718</b>	<b>2,858,343</b>

2. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit
3. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 55, pika 6.

Konceptoi: D.Zeraj

S.Haxhiraj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORE

Nr. 3067 prot.

Vlorë, më 13 . 03 2023

RELACION

**MBI PROJEKT VENDIMIN PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PËR  
PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026**

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar Këshilltar,

Projekt vendimi që ju paraqesim për miratim është një ndër aktet që i paraqitet Këshillit të Bashkisë në vijim të punës për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026.

Në këtë projekt vendim është paraqitur parashikimi i Administratës së Bashkisë për realizimin e të ardhurave në periudhën afatmesme 2024-2026. Ky parashikim është realizuar duke patur parasysh planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të veta në vitet 2021, 2022 dhe 2023 si dhe ndryshimet e mundshme në vitet e ardhshme. Për të dhënat për grantin e pakushtëzuar parashikimi është bazuar sikurse janë parashikuar nga qeveria sipas Shtojcës Nr.1 të Udhëzimit Nr.6 datë 28.02.2023 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026". Ndërkohë po sipas udhëzimit të sipërcituar transferata e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2024-2026 do të jetë 1% më e lartë për çdo vit duke filluar nga viti 2023 në të cilin është shuma 447,453 mijë lekë.

Nëse i referohemi të ardhurave të veta për vitin 2021 rezulton se janë planifikuar në shumën 1,410,692,000 lekë dhe janë realizuar në shumën 1,006,714,000 lekë ose 72%. Ndërkohë në vitin 2022 janë planifikuar në shumën 1,399,948,000 lekë dhe janë realizuar në shumën 1,209,835,000 lekë ose 86%.

Për vitin 2023 shuma e planifikuar nga të ardhurat e veta është 1,438,585,000 lekë ose afërsisht është 3% më shumë nga plani i vitit 2022. Duke qenë se të ardhurat e realizuara në fakt ato të vitit 2022 kanë qenë më të larta se çdo vit tjetër ,por që edhe ato janë në masën 86% të planit për vitet 2024-2026 është parashikuar rritje e të ardhurave të veta në masën jo më shumë se 5% në çdo vit. Edhe kjo rritje është parashikuar bazuar në tendencën në rritje të treguesve fiskalë, por veçanërisht në shfrytëzimin më të mirë të rezervave ekzistuese përse i përket bizneseve si tatimpagues por edhe subjekteve familjare për taksa e tarifa ku dihet se aktualisht këta nuk janë të përfshirë 100%. Po ashtu në parashikimin e këtyre të ardhurave janë mrrë parasysh edhe mosrealizimet e të ardhurave të planifikuara ndër vite për taksën e tokës buqësore që me masa shtesë mund të përmirësohet. Ndërkohë investimet e bëra në infrastrukturë veçanërisht në zonat bregdetare vlerësohet se do të krijojnë mundësinë e rritjes së hapsirës publike të dhënë për shfrytëzim në qytet si dhe si hapsirë plazhi.

Të nderuar Këshilltarë,

Të dhënat e paraqitura në këtë projekt vendim janë si tregues fillestar paraprak të cilat në vijimësi do të detajohen në mënyrë më të plotë nisur edhe nga analiza e realizimit të të ardhurave të veta gjatë vitit 2023. Kjo nisur dhe nga eksperiencia e viteve të kaluara në të cilat këta tregues kanë ndryshuar nga momenti i miratimit të treguesve përgatitorë deri në momentin e miratimit të treguesve përfundimtarë. Koncretisht për vitin 2023 në Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 parashikimi i të ardhurave ka qenë në shumën 2,432,959,000 lekë, ndërkohë që në buxhetin e vitit 2023 ky tregues është në shumën 2,560,434,000 lekë në total gjë që reflektohet dhe në ndyshimin e parashikimit të të ardhurave të veta. I njëjti vlerësim është bërë në projekt vendimin që po ju paraqesim edhe për parashikimet e të ardhurave të veta në vitet 2024-2026. Rrjedhimisht në momentin që do të paraqiten parashikimet përfundimtarë për të ardhurat dhe shpenzimet per Programin Buxhetor Afatmesëm që do të miratohet në fund të këtij viti këta tregues do të qartësohen më mirë dhe do të jenë përfundimtarë. Në këto kushte kërkojmë nga ana juaj të miratoni këtë projekt vendim me qëllim të hapim rrugë për procedurat e mëtejshme të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 të Bashkisë Vlorë.

Konceptoi: D. Zeraj

**KRYETARI**  
**Dritan LElli**

